



Kosovo Roma Ashkali and Egyptian
KRAEEYN
Early Years Network

POLITIKË REKOMANDUESE PËR ZHVILLIMIN NË FËMIJËRINË E HERSHME



Hyrje

Kjo politikë rekomanduese për zhvillimin në fëmijërinë e hershme është hartuar në kuadër të Koalicionit të OJQ-ve për Mbrojtjen e Fëmijëve – KOMF në bashkëpunim me Rrjetin Kosovar të Komuniteteve Roma, Ashkali dhe Egjiptas për Edukimin në Fëmijërinë e Hershme – KRAEEYN.

Dokumenti përshkruan situatën lidhur me zhvillimin në fëmijërinë e hershme dhe ofron një pasqyrë të disa prej fushave prioritare për ndërhyrje në hartimin dhe zbatimin e politikave dhe ofron rekomandime se si duhet adresuar dhe trajtuar ato. Duke pasur parasysh që Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë është dikasteri udhëheqës për zhvillimin e politikave dhe strategjive për zhvillimin e fëmijërisë së hershme, kjo politikë i adresohet jo vetëm MASHT por edhe ministrive tjera bashkë përgjegjëse sikurse MPMS dhe MSH.

Koalicioni i OJQ-ve për Mbrojtjen e Fëmijëve në Kosovë – KOMF, i themeluar në vitin 2011, është një koalicion i përbërë nga 29 organizata jo qeveritare vendore dhe ndërkombëtare të cilat punojnë në fushën e mbrojtjes së fëmijëve, me mision të përbashkët avokimin për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve në Kosovë.

Ky publikim nuk reflekton domosdoshmërisht qëndrimet e donatorëve të KOMF.

Foto:

www.pexels.com

Autorë:

Remzije Krasniqi – SOS Fshatrat e Fëmijëve në Kosovë

Hana Zylfiu Haziri – Qendra për Arsim e Kosovës

Mevlude Murtezi – CIPOF

Muhamet Arifi – Balkan Sunflowers Kosova

Saranda Rexha – Education Comes First

Loreta Keqekolla – KOMF

Donjeta Kelmendi – KOMF

Përmbledhje e situatës

Në Kosovë, fëmijëria e hershme mbetet niveli më i pa priorizuar ku investimet janë minimale. Fëmijëria e hershme kuptohet si nocion i cili përfshin më shumë edukimin parashkollor.¹

Shërbimet për zhvillimin në fëmijërinë e hershme nuk janë të integruara mes sektorëve të arsimit, shëndetësisë dhe atë të mirëqenies sociale. Shërbimet janë të izoluar, të pa integruara dhe të pakoordinuara – familja endet dhe shkon nëpër institucione të ndryshme për të marrë shërbimet. Shërbimet e mirëqenies dhe shëndetësisë ende mbeten larg prioritizimit dhe ofrimit të tyre në fushën e fëmijërisë së hershme. Kjo është pasojë e shkëputjes thuajse complete të këtyre tre shërbimeve kryesore për fëmijë si në nivel qendror, po ashtu edhe në atë lokal.

Kosova vazhdon të mbetet vendi me përfshirjen më të ulët të fëmijëve në edukimin parashkollor në Europë. Vetëm 4.8% e fëmijëve të moshës së nivelit parashkollor janë të përfshirë në edukimin parashkollor. Shkaku kryesor për një pjesëmarrje kaq të ulët është kapaciteti i vogël absorbues i rrjetit të institucioneve parashkollore me kosto të përballueshme dhe vetëdijes së përgjithshme për format tradicionale të edukimit brenda familjes. Ndërsa, sa i përket fëmijëve të moshës 5 - 6 vjeçare janë regjistruar 90.1% e fëmijëve. Ndërkaq, shkalla e përgjithshme e pjesëmarrjes në edukimin parashkollor (parashkollor dhe parafillor) është 18.6%.²

Të gjitha 43 institucionet parashkollore publike janë të koncentruara në zona urbane; Zonat rurale thuajse janë të përjashtuara nga ofrimi i shumë shërbimeve për FH (përveç disa iniciativave të organizatave jo qeveritare). Poashtu fëmijët që vijnë nga grupet e marginalizuara edhe pse janë të liruar nga pagesa, shumë shpesh nuk përfshihen për shkak të kufizimit të numrit të fëmijëve. Kemi vetëm një numër tejet të vogël të fëmijëve rom, ashkali dhe egjiptian në institucione parashkollore. Pra, nga shërbimet e fëmijërisë së hershme kryesisht përfitojnë një shtresë e caktuar e popullatës e cila ka një situatë më të favorshme financiare dhe sociale. Një numër i madh i kopshteve private punojnë pa licencë dhe mungon sistemi i monitorimit. Poashtu evidentojnë probleme me infrastrukturën, standardet dhe tekstet për sistemin parashkollor.

Duke qenë se vetëm 4.8% e fëmijëve të moshës së nivelit parashkollor janë të përfshirë në institucionet parashkollore, pjesa dërmuese e fëmijëve në vitet e para mbeten në mjediset në shtëpi kryesisht me nënat e tyre (shpesh, të papuna) si kujdestare parësore pa ndonjë mbështetje profesionale institucionale.

Në Kosovë ka mungesë të programeve alternative për zhvillimin në fëmijërinë e hershme. Është e domosdoshme zhvillimi i programeve për mbështetjen e prindërve, familjeve dhe kujdestarëve në ambientet familjare të fëmijëve, jashtë mjediseve institucionale.

UNESCO e përcakton fëmijërinë e hershme si periudhën nga lindja deri në një vit para hyrjes në shkollë fillore, duke theksuar rëndësinë e atyre viteve të hershme për rezultatet e mëvonshme të zhvillimit. Zbulimet e reja në studimin e trurit tregojnë se fëmijët mësojnë që nga lindja dhe se vitet e para të jetës ndikojnë në suksesin e tyre të mëvonshëm në shkollë dhe në jetë.

Programi për Zhvillim të Qëndrueshëm i Kombeve të Bashkuara, objektiva 4 thotë se: deri në vitin 2030, të sigurohet që të gjithë fëmijët të kenë qasje në zhvillimin cilësor që në fëmijëri të hershme, kujdes dhe edukim parashkollor në mënyrë që ata të jenë të gatshëm për arsimin fillor.” Shërbimet e ndërhyrjes në fëmijërinë e hershme janë thelbësore për të siguruar që të gjithë fëmijët të arrijnë potencialin e tyre të plotë.

¹Raporti i vlerësimit të nevojave për zhvillimin në fëmijërinë e hershme, KOMF 2019

²Të dhënat nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, 2018

Nevojat e përgjithshme në zhvillimin në fëmijërinë e hershme

KOMF gjatë 2019 ka zhvilluar një proces të vlerësimit të nevojave në zhvillimin e fëmijërisë së hershme, në mënyrë që të zhvillojë kapacitetet në këtë fushë. Bazuar në këtë raport, nevojat e përgjithshme në zhvillimin në fëmijërinë e hershme përfshijnë:

Hartimi i strategjisë nacionale për fëmijërinë e hershme duke përfshirë fushat e arsimit, shëndetësisë dhe mirëqenies e cila do parasheh korniza për shërbime të integruara;

Hartimi i ligjit për zhvillimin e fëmijërisë së hershme;

Finalizimi i kurrikulës bërthamë për moshën 0 - 5. Largimi i grup moshës 5 - 6 nga kurrikula shkollore, niveli I dhe përfshirja në kurrikulën parashkollore;

Rritja e numrit të institucioneve parashkollore, nxitja e partneritetit publiko privat;

Zhvillimi i programeve alternative për zhvillimin në fëmijërinë e hershme; Dizajnimi i shërbimeve mbështetëse për familjet: Vizitat në familje; Klubet e prindërve; Sesione/punëtori këshilluese në familje komunitet etj;

Rregullimi i legjislacionit për zhvillimin e shërbimeve të integruara dhe alternative për FH, duke përfshirë shërbimet arsimore, shërbimet sociale dhe shëndetësore;

Zhvillimi i programeve për identifikim, intervenim dhe vlerësim në FH;

Rritja e cilësisë së shërbimeve parafillore (përgatitore), deshklarizmi i klasës parafillore, rritja e cilësisë së mjeteve dhe teksteve të punës, infrastrukturës;

Plotësim ndryshimi i standardeve të edukimit parashkollor për të përfshirë moshën 0 – 6 vjeç dhe për të rregulluar mangësitë e identifikuar lidhur me infrastrukturën dhe standardet minimale;

Funksionalizimi i shërbimeve profesionale përfshirë profilet: logoped, psikolog, ftiziatër, pediatër, nutricionist, asistentë mbështetës;

Përmirësimi i vlerësimit dhe inspektimit të cilësisë së shërbimeve parashkollore;

Zhvillimi i fushatave ndërgjegjësuere për prindër dhe politikëbërës për zhvillimin në fëmijërinë e hershme;

Vetëdijësimi, priorizimi i DKA-ve për të dedikuar objektet që mund të modifikohen për ofrimin e shërbimeve në FH si dhe shfrytëzimi i objekteve apo hapësirave të lira në shkolla për këto shërbime, gjë që do t'i hapte mundësi OJQ-ve të veprojnë dhe orientojnë programet e tyre drejt kësaj qasjeje;

Rritja e shkallës së ofrimit të asistencës sociale për familjet me fëmijë mbi moshën 5 vjeçare;

Ofrimi i shtesave për fëmijë për çdo familje deri në moshën 18 vjeç;

Ofrimi i shërbimeve edukative për fëmijët e hospitalizuar;

Krijimi i platformës online për FH e cila përmban publikime, hulumtime, analiza, informata, inovacione, rekomandime, reagime, bllog e cila mund të përdoret nga prindërit dhe profesionistët.

Çështjet prioritare të adresuara në këtë politikë rekomanduese:

- Fuqizimi i mekanizmave për mbrojtjen e fëmijëve në fëmijëri të hershme
- Kurrikulat parashkollore (0 - 5 dhe 5 - 6)
- Librat për moshën parafillore (grup moshë 5 - 6)
- Integrimi i shërbimeve për zhvillimin në fëmijërinë e hershme
- Zhvillimi i programeve alternative për zhvillimin në fëmijërinë e hershme
- Partneriteti publiko-privat si mundësi për rritje të përfshirjes së fëmijëve në edukim parashkollor
- Infrastruktura dhe standardet për zhvillimin në fëmijërinë e hershme

Çështjet për ndërhyrje emergjente, rekomandimet dhe afatet kohore për intervenim

Fuqizimi i mekanizmave për mbrojtjen e fëmijëve në fëmijëri të hershme

Draft Ligji për Fëmijërinë e Hershme, Ligji për Shërbime Sociale dhe Familjare³, legjislati në fushën e shëndetësisë, duhet të parashikojë krijimin e Politikës për Mbrojtjen e Fëmijëve për ofruesit e shërbimeve të fëmijërisë së hershme e cila siguron:

- Mbrojtjen e fëmijëve nga abuzimi, shfrytëzimi dhe neglizhimi nga kujdestarët, edukatorët, ofruesit e shërbimeve dhe ata që kanë qasje në informacionet e tyre personale apo që kanë kontakt me fëmijë;
- Mbrojtjen e personelit në kuadër të institucioneve parashkollore, mbrojtjen e ofruesve të shërbimeve sociale dhe shëndetësore;
- Krijimin e një sistemi të shpejtë dhe efektiv të reagimit dhe raportimit në rast të dyshimeve apo abuzimeve eventuale;
- Marrjen e trajnimeve periodike me qëllim të ngritjes së kapaciteteve dhe vetëdijesimit të stafit në kontakt me fëmijë;
- Monitorimin dhe rishikimin e vazhdueshëm të zbatimit të politikës brenda institucionit;
- Rekrutim të sigurt të personelit që punon në institucionet arsimore, sociale dhe shëndetësore;
- Zbatim të parimeve të Konventës për të Drejtat e Fëmijës.

Arsyetimi:

Vlerësojmë se Ligji për Edukimin Parashkollor⁴ i hartuar në vitin 2006, Ligji për Shërbime Sociale dhe Familjare nuk janë në hap me politikat, praktikat dhe standardet sa i përket mbrojtjes së fëmijëve në institucionet parashkollore, qendrat në komunitet, qendrat ditore, qendrat për mësim shtesë etj. Legjislati nuk përcakton krijimin dhe zbatimin e Politikës për Mbrojtjen e Fëmijëve në institucionet që punojnë më fëmijë, si mjet kyç për të siguruar ambient të sigurtë dhe mbrojtës për fëmijët.

Aktualisht, institucionet dhe programet alternative në Kosovë nuk kanë Politikë për Mbrojtjen e Fëmijëve, për pasojë nuk kanë një sistem për parandalim dhe mbrojtje të fëmijëve e as sistem të brendshëm të reagimit dhe raportimit. Pra, politika për mbrojtjen e fëmijëve do të përfshijë veprimet parandaluese me qëllim të minimizimit të rrezikut për fëmijët si dhe veprimet reaguese me qëllim të identifikimit, raportimit dhe trajtimit në kohë, të rasteve të incidenteve.

Në mungesë të një politike të tillë, secili institucion është më i rrezikuar ndaj dyshimeve dhe abuzimit qofshin ato të rremë apo të vërtetë.

Rekomandime:

- Përfshirja e politikës së mbrojtjes së fëmijëve në kuadër të Ligjit për fëmijërinë e hershme dhe Ligjit për Shërbime Sociale dhe Familjare;
- Krimi i UA për zbatimin e politikës për mbrojtjen e fëmijëve;
- Ngritja e kapaciteteve përmes trajnimeve për profesionistët që punojnë në fëmijëri të hershme;
- Monitorimi dhe vlerësimi i zbatimit të politikës për mbrojtjen e fëmijëve.

Afati kohor: 24 muaj.

³ Ligji Nr. 02/L-17 për Shërbime Sociale dhe Familjare, <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2447> dhe Ligji Nr. 04/L-081 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 02/L-17 për Shërbime Sociale dhe Familjare, <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2808>

⁴ Ligji Nr. 02/L-52 mbi Edukimin Parashkollor, <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2401>

Kurrikulat parashkollore (0 - 5 dhe 5 - 6)

Nëse bazohemi në praktikën nga terreni të gjitha institucionet parashkollore dhe klasat parafillore planifikojnë punën e tyre me Kurrikulën parashkollore 3 - 6 të vitit 2006, e disa institucione planifikojnë punën edhe bazuar në Standardet e zhvillimit dhe të mësuarit në fëmijërinë e hershme 0 - 6 vjeç, e që si veprim nuk është në rregull, sepse ky dokument duhet të jetë vetëm dokument mbështetës i punës edukative për arritjen e rezultateve të të nxënimit sipas kurrikulës.

Gjatë 3 viteve të fundit është punuar në dy drafte Kurrikula parashkollore 0 – 5 vjeç, me dy grupe të ndryshme punuese pa pjesëmarrjen e shoqërisë civile dhe prindërve. Nga të dy draft dokumentet Kurrikulare nuk kemi informata a janë inkorporuar komentet e dërguara të cilat i kanë dhënë ekspertët, institucionet dhe organizatat e ndryshme.

Ministri i MASHT-it në largim, pa pasur një konsultim përfundimtar me komunitetin arsimor, ka sjell një vendim për të hyrë në fuqi drafti i dytë i dokumentit dhe ka kërkuar nga institucionet parashkollore ta zbatojnë atë. Ky dokument nuk është shpërndarë dhe nuk gjendet askund në faqen zyrtare të MASHT. Kolegjiumi i drejtorëve të Institucioneve Parashkollore ka reaguar për këtë vendim të ministrit dhe ka kërkuar sqarim, por deri tani nuk kanë marrë përgjigje.

Rekomandime:

- Dy dokumentet të rishikohen në tërësi sepse janë identifikuar mangësi të theksuara përmbajtësore;
- Dokumenti i ri i Kurrikulës parashkollore 0-5 vjeç të përfshijë edhe klasën parafillore;
- Të formohet një grup punues i përbërë nga MASHT, MSH, MPMPS, ekspertë, përfaqësues nga Këshilli i prindërve të Kosovës, përfaqësues të institucioneve parashkollore, organizatat që punojnë në fushën e fëmijërisë së hershme etj, të cilët do të analizojnë dhe kontribuojnë në hartimin e Kurrikulës.

Arsyetimi:

Ndarja e kurrikulave në dy dokumente të veçanta për grupmoshat e fëmijëve 0 – 5 vjeç dhe 5 - 6 vjeç, përgjithësisht konsiderohet si qasje jo e drejtë duke krijuar vështirësi të theksuara në ndërlidhjen e rezultateve për shkollë si dhe zbatimin e saj në praktikë. Kjo krijon konfuzion dhe paqartësi tek edukatorët dhe praktikuesit, të cilët do të duhet të punojnë me të dy dokumentet. Një shembull i ndarjes së tillë nuk përkon me praktikën më të mira bashkëkohore të fëmijërisë së hershme. Për më tej, kështu të ndara si pretendojnë të jenë, mund të jenë sfiduese si në të kuptuar po ashtu edhe në zbatueshmëri të dy kurrikulave.



Komentet e përgjithshme rreth dy drafteve:

- Qëllimi i kurrikulës duhet përcaktuar qartë, qëllim ky që duhet të përcaktoj tutje rrjedhën e dokumentit si dhe përdorimin praktik të tij. Për më tej, nuk ka koherencë mes asaj që është prezentuar si qëllim dhe parimeve e objektivave të listuara;
- Në dy draft dokumente vërehen gabime në terminologji e edhe në nocione. Ka shpërputhje në konceptet e prezantuara dhe nevojitet unifikimi i terminologjisë përgjatë gjithë dokumentit;
- Në draft dokumente hasim jo konsistencë në strukturë, definicione dhe përdorim të koncepteve;
- Moshë 0 - 3 vjeç mbetet nën hije dhe nuk elaborohet në draft dokumente sikurse mosha 3 – 5 vjeç. Kjo konsiderohet shqetësuese dhe vërehet mungesa e ekspertëve të kësaj moshe në hartimin e drafteve. Është e paqartë edhe grupmosha 0, meqë kudo në botë, kurrikula fillon nga mosha 1 vit; apo bazuar në sistemin e organizimit të edukimit në fëmijëri të hershme (nëse fëmijët fillojnë programin në fëmijëri të hershme nga mosha 9 muajsh kjo duhet të përkohet edhe me programet dhe shërbimet që ofrohen për zhvillimin dhe mirëqenien e tyre);
- Bazuar në moshën dhe veçantitë e saj zbatimi i kurrikulës duhet të ketë qasje të integruar, i ndërlidhur me punën dhe jetën e përditshme të fëmijëve, duke u mundësuar që ta kuptojnë drejt marrëdhënien e tyre me mjedisin natyror dhe me mjedisin e krijuar nga njeriu, pavarësisht se ku zhvillohet ky sistem në shkolla fillore apo institucione parashkollore;
- Puna në klasët përgatitore nevojitet të ri-organizohet duke krijuar mjedis miqësor për fëmijën ambient ku fëmijët ndihen të sigurtë, të barabartë dhe të qetë. Shumica e klasave përgatitore aktuale kanë elemente të një klase për grupmoshat e mëdha me mungesë të madhe të materialeve didaktike, lodrave, inventar të papërshtatshëm për grupmoshën 5 - 6 vjeç. Duke pasur parasysh që në klasën përgatitore (mosha 5 - 6 vjeç), fëmijët përveç shkathtësive e shprehive sociale, krijojnë bazat themelore të të nxënies dhe përgatiten për të arriturat e tyre akademike, që përfaqësojnë elementet themelore të leximit, të shkrimit dhe të veprimeve me numra, me çka rritet gatishmëria e tyre për shkollim fillor. Kësaj moshë duhet tu mundësohet eksplorimi dhe analiza në ambiente sa më sfiduese, me materiale të përshtatshme. Moshë parafillore si edhe ajo parashkollore element kryesorë kanë lojën, prandaj ambienti i dhomave/klasave të punës duhet të dallojë nga ambientet tipike shkollore.

Afati kohor: 6 muaj.



Librat për moshën parafillore (grup mosha 5 – 6 vjeç)

Vitin e kaluar MASHT ka iniciuar botimin e librave për punë me fëmijë të moshës parafillore. Shtëpia botuese fituese ka përgatitur një pako me libra, fletë pune dhe materiale të ndryshme të cilat konsiderohen që peshojnë rreth 7 - 8 kg. Përveç peshës, numrit të librave, fletoreve të punës, materialeve të tjera, përmbajtja pedagogjike dhe kërkesat dhe detyrat që dalin nga librat dhe fletët e punës për grupmoshën 5 - 6 vjeç është e stërngarkuar. Sa i përket këtyre librave/pakos, vlerësimi i ekspertëve të edukimit parashkollor konstaton se këto libra nuk janë fare të përshtatshme për këtë moshë, duke u bazuar në arsyetimet e mëposhtme.

Arsyetimi:

- Për këtë moshë nuk preferohet të ketë libra specifik;
- Fëmijët e kësaj moshë zhvillohen dhe mësojnë duke luajtur, jo duke bërë detyra, duhet pasur në mendje se loja ju jep mundësi të eksplorojnë dhe mësojnë gjëra të reja. Përmes lojës mund të mësohen të gjitha përmbajtjet që mund të ofroj një libër;
- Ekziston tendenca e rrezikshme e shkollarizimit të klasës parafillore, gjë që këto libra e forcojnë këtë qasje. Kjo shkon përtej normave të zhvillimit të kësaj moshe, ku fëmijëve nuk duhet tu kërkohej që të ulen dhe të bëjnë detyra sipas kërkesave të librit;
- Paraqitja e shkronjave dhe numrave, nuk është në harmoni me atë se çka mësohet në klasën e parë. Fëmijët e kësaj moshe mund të mësojnë konceptet e numrave dhe shkronjave, por përmes lojës dhe aktiviteteve kreative e jo duke u imponuar shkrimin e tyre;
- Ka shumë burime tjera shumë të përshtatshme të cilat edukatorët/ët mund të përdorin për të mësuar fëmijët, duhet marr parasysh se shpërndarja e kësaj pako mund të kufizojë edukatorët/ët në gjetjen e këtyre burimeve;
- Pakoja është aq e madhe dhe e ngarkuar, po ashtu është frustruese për fëmijët të cilët nuk dinë të lexojnë dhe dallojnë përmbajtjen;
- Përmbajtja e pakos, kalon pritshmëritë e kësaj moshe, shumica e teksteve, dhe kërkesave janë përtej pritjeve të moshës;
- Për të përcjellë zhvillimin e fëmijëve dhe të arriturat, edukatori/ja duhet të vëzhgojë fëmijën, jo të vlerësoj detyrat e tij/saj të paraqitura në një copë letre.

Rekomandim:

- Përdorimi i pakos me libra të ndërprehet menjëherë apo të modifikohet me materiale didaktike që mund të shërbejnë si burime shtesë për edukatorët për të nxitur përdorimin e materialeve të shtypura.

Afati kohor: 1 muaj.

Integrimi i shërbimeve në fëmijërinë e hershme

Draft Ligji për Fëmijërinë e Hershme duhet të përcaktojë integrimin e shërbimeve për zhvillimin në fëmijërinë e hershme në mes të sektorëve të arsimit, shëndetësisë dhe mirëqenies sociale. Poashtu, integrimi i shërbimeve për zhvillimin në fëmijërinë e hershme duhet të reflektohet edhe në legjislacionin e mirëqenies sociale dhe shëndetësisë.⁵

Ekzistojnë modele të ndryshme të integritit të shërbimeve mes sektorëve për zhvillimin në fëmijërinë e hershme, disa prej tyre janë të elaboruar më poshtë.

Integrimi i shërbimeve në fëmijërinë e hershme mund të bëhet përmes punësimit të profesionistëve punëtor social dhe pediatër, apo profilet tjera si psikolog, pedagog, logoped, terapistë të fushave të ndryshme, në kuadër të institucioneve arsimore për zhvillimin në fëmijërinë e hershme.

Alternativa e dytë është ofrimi i shërbimeve sociale, psikologjike, shëndetësore në institucionet parashkollore nga punëtorët social të Qendrave për Punë Sociale dhe profesionistët shëndetësorë nga Qendrat e Mjekësive Familjare.

KOMF potencon që alternativa e parë siguron shërbime më cilësore, por që mbart kosto më të lartë financiare në implementim. Alternativa e dytë, nuk siguron cilësi sikurse alternativa e parë, por është më kosto efektive.

Draft Ligji për Fëmijërinë e Hershme duhet të parasheh integrimin e shërbimeve me sektorët e tjerë për ofrimin e shërbimeve në familje për zhvillimin në fëmijërinë e hershme përmes realizimit të vizitave sistematike në shtëpi bashkë me profesionistët shëndetësor, social dhe arsimor, për të bërë identifikim të hershëm, menaxhim të rasteve dhe ofrim të mbështetjes për prindërit dhe kujdestarët për zhvillimin në fëmijërinë e hershme.

Draft Ligji për Fëmijërinë e Hershme duhet të parashoh integrimin e shërbimeve arsimore me sektorët e tjerë përmes krijimit të protokolleve integruese për referim dhe trajtim të rasteve si dhe përmes krijimit të databazës së integruar me sektorët e tjerë, sektorin e shëndetësisë, të arsimit dhe atë të mirëqenies sociale.

Duke qenë që integrimi i shërbimeve kërkon konsensus mes sektorëve, rekomandohet që pajtueshmëria mes sektorëve të përfshirë në nivel qendror të arrihet para aprovimit të këtij ligji. Modellet e integritit të shërbimeve të cilat do të aplikohen në kuadër të këtij ligji, duhet të diskutohen dhe të përcaktohen në bashkëpunim me të gjithë sektorët e mësipërm.

Arsyetimi:

Në Kosovë, shërbimet për zhvillimin në fëmijërinë e hershme nuk janë të integruara mes sektorëve të arsimit, shëndetësisë dhe atë të mirëqenies sociale. Shërbimet janë të izoluara, të pa integruara dhe të pakoordinuara – familja endet dhe shkon nëpër institucione të ndryshme për të marrë shërbimet. Shërbimet janë vetëm të natyrës kuruese, sikurse shërbimet për fëmijët me aftësi të kufizuara të diagnostifikuara. Shërbimet ofrohen kryesisht në ambient klinik, qendra rehabilitimi dhe jo në familje.

Duke parë rëndësinë e madhe, për një sistem të integruar të shërbimeve për zhvillimin në fëmijërinë e hershme, rekomandohet që integrimi i shërbimeve për zhvillimin në fëmijërinë e hershme të adresohet në kuadër të Draft Ligjit për Fëmijërinë e Hershme dhe Draft Ligjit për Shërbime Sociale dhe Familjare.

⁵ Raporti i vlerësimit të nevojave për zhvillimin në fëmijërinë e hershme, KOMF 2019

Aktualisht, në institucionet parashkollore nuk zhvillohet punë sociale, identifikim të hershëm dhe menaxhim të rasteve. Qendrat për Punë Sociale nuk kanë të dhëna për zhvillimin në fëmijërinë e hershme apo rastet në kuadër të institucioneve parashkollore si dhe në familje, për pasojë nuk ka ofrim të shërbimeve sociale për zhvillimin në fëmijërinë e hershme qoftë në institucione parashkollore apo në familje. Për momentin, qasja e QPS është reaktive, në pritje të klientëve apo rasteve sociale, përderisa mungon qasja proaktive drejt identifikimit të rasteve përmes vizitave apo punës në institucione parashkollore, në familje dhe komunitet.

Një model i mirë i integrit të shërbimeve është vizitat sistematike në shtëpi. Aktualisht, një model i tillë në Kosovë praktikohet nga profesionistët shëndetësorë të kujdesit parësor përmes vizitave sistematike mjekësore në shtëpi të realizuara nga profesionistët në kuadër të Qendrave të Mjekësive Familjare. Vizitat në shtëpi ka për qëllim të sigurojë mbrojtje shëndetësore për grupet më të cenueshme të popullatës, me theks të veçantë për kategorinë e nënave dhe fëmijëve. Një model i tillë do të ishte i përshtatshëm edhe për shërbimet arsimore për të ofruar mbështetje për prindërit dhe kujdestarët për zhvillimin në fëmijërinë e hershme. Duke qenë se vizitat në shtëpi realizohen në kuadër të sektorit të shëndetësisë, një pajtueshmëri dhe bashkërendim paraparak në mes të MASHT dhe MSH është i domosdoshëm para inkorporimit të këtij modeli në këtë ligj. Vizitat sistematike në shtëpi do mund të realizoheshin bashkarisht me profesionistët shëndetësorë dhe social.

Aktualisht, nuk ka protokolle identifikimi, referimi të integruara për rastet e fëmijëve. Poashtu nuk ka një databazë të integruar sa i përket rastet të fëmijëve në mes të sektorëve. Secili sektor posedon të dhënat sipas databazës së vet.

Rekomandime:

- Integrimi i shërbimeve arsimore me shërbimet shëndetësore dhe sociale në Draft Ligjin për Fëmijërinë e Hershme dhe ligjet tjera që prekin të drejtat e fëmijëve;
- Përfshirja e profesionistëve punëtor social dhe pediatër, apo profilet tjera si psikolog, pedagog, logoped, terapistë të fushave të ndryshme, në kuadër të institucioneve arsimore për zhvillimin në fëmijërinë e hershme;
- Realizimi i vizitave sistematike në shtëpi bashkë me profesionistët shëndetësor dhe social, për të bërë identifikim të hershëm, menaxhim të rasteve dhe ofrim të mbështetjes për prindërit dhe kujdestarët për zhvillimin në fëmijërinë e hershme;
- Krijimi i protokolleve integruese për referim dhe trajtim të rasteve në fëmijërinë e hershme;
- Krijimi i databazës së integruar me sektorët e tjerë, sektorin e shëndetësisë dhe atë të mirëqenies sociale;
- Hartimi i procedurave për bashkëpunim dhe koordinim horizontal dhe vertikal ndërinstitucional.

Afati kohor: 24 muaj.



Zhvillimi i programeve alternative për zhvillimin në fëmijërinë e hershme

Duke qenë se vetëm 4.8% e fëmijëve të moshës së nivelit parashkollor janë të përfshirë në institucionet parashkollore, shumica e fëmijëve në vitet e para mbeten në mjediset në shtëpi kryesisht me nënat e tyre si kujdestare parësore pa ndonjë mbështetje profesionale institucionale. Në anën tjetër ka mungesë të programeve alternative për zhvillimin në fëmijërinë e hershme, programe për mbështetjen e prindërve, dhe kujdestarëve në ambientet familjare të fëmijëve, jashtë mjediseve institucionale.⁶

Është më se e domosdoshme zhvillimi i programeve alternative duke përfshirë edhe ndërhyrjen në fëmijërinë e hershme si një sistem ndërdisiplinor, ndërsektorial dhe i koordinuar i shërbimeve intensive për prindër dhe fëmijë (nga 0 deri në regjistrimin në sistemin arsimor), duke përfshirë edhe fëmijët e cenusshëm, me vështirësi në zhvillim, me aftësi të kufizuara, çrregullime në sjellje, ose fëmijët që kanë nevojë tu ofrohet kujdes për shëndetin mendor.⁷

Programet alternative duhet të përfshijnë: programet për mbështetjen e prindërve, qendrat në komunitet, qendrat ditore, kujdesi për fëmijët në familje, ndërhyrja në fëmijërinë e hershme, grupet e prindërve, vizitat sistematike në shtëpi, ekipet mobile për fëmijëri të hershme, platformat online për fëmijëri të hershme për prindërit dhe profesionistët etj.⁸

Ndërhyrja në fëmijërinë e hershme përcaktohet si ofrimi i mbështetjes për familjet e foshnjeve dhe fëmijëve dhe dhënie e mbështetjes për të përmirësuar zhvillimin e fëmijëve dhe jetën familjare. Ndërhyrja e hershme duhet të jetë e natyrës parandaluese. Qasja me familjen në qendër është jetike për shërbimet e ndërhyrjes në fëmijëri të hershme.⁹

Është me rëndësi jetike rregullimi ligjor dhe zhvillimi i programeve alternative me shërbime të integruara për zhvillimin në fëmijërinë e hershme. Në mënyrë që të kemi programe alternative me shërbime të integruara, është shumë i rëndësishëm miratimi i Ligjit për Fëmijërinë e Hershme dhe/ose përfshirja e shërbimeve të integruara në dokumentet normative të MASHT, si dhe ministrive mbështetëse (MSH, MPMS). Krahas rregullimit ligjor të programeve alternative me shërbime të integruara për zhvillimin në fëmijërinë e hershme, programet alternative duhet të ndërtohen mbi kapacitetet e shërbimeve ekzistuese të fëmijërisë së hershme dhe në bashkëpunim me shërbimet përkatëse.

MASHT bashkë me MPMS, MSH dhe komunat duhet të investojnë në zhvillimin e programeve alternative për zhvillimin në fëmijërinë e hershme.

Arsyetimi:

Aktualisht në Kosovë, ka mungesë të programeve alternative sikurse programe për mbështetjen e prindërve, mungesë të vizitave sistematike në shtëpi për zhvillimin në fëmijërinë e hershme, shërbime për ndërhyrje në fëmijërinë e hershme në familje, mungesë të qendrave ditore, qendrave mësimore, qendrave në komunitet, grupet mbështetëse të prindërve etj.

Qendrat mësimore ekzistuese të organizuara nga OJQ-të për mësim shtesë janë duke u përballuar me një sërë sfidash për shkak të mungesës së financimit dhe neglizhencës së përgjegjësive institucionale, duke rrezikuar mbylljen e tyre. MASHT ka dështuar në zbatimin e kornizës ligjore për funksionimin e Qendrave Mësimore, përkatësisht Udhëzimin Administrativ Nr.12/2017 për Themelimin dhe Funksionimin e Qendrave Mësimore.

⁶ Raporti i vlerësimit të nevojave për zhvillimin në fëmijërinë e hershme, KOMF 2019

⁷ Udhëzuesi për Ndërhyrjen në Zhvillimin në fëmijërinë e Hershme, KOMF 2019

⁸ Udhëzuesi për Ndërhyrjen në Zhvillimin në fëmijërinë e Hershme, KOMF 2019

⁹ Udhëzuesi për Ndërhyrjen në Zhvillimin në fëmijërinë e Hershme, KOMF 2019

MASHT bashkë me MPMS dhe MSH duhet të parashikojnë ndërtimin e një rrjeti të programeve alternative për mbështetjen në fëmijërinë e hershme në familje dhe komunitet. Programet dhe shërbimet duhet të jenë të natyrës parandaluese të ndërhyrjes, të përqendruar në familje dhe pikat e saj të forta. Qasja e punës duhet të jetë me familjen në qendër dhe shërbimet nuk duhet të ofrohen vetëm për fëmijë por për tërë familjen.

Në disa prej komunave të Kosovës, në kuadër të Qendrave të Mjekësive Familjare janë hapur Klasat për Nëna dhe Fëmijë. Qëllimi i këtyre klasave është të ndikojë në përmirësimin e shëndetit të nënës dhe fëmijës përmes edukimit shëndetësor të nënave nga para-lindja deri tek procesi i pas-lindjes dhe kujdesit për fëmijën, duke ndikuar edhe në zhvillimin në fëmijërinë e hershme. MSH bashkë me komunat të zgjerojnë këtë program në të gjitha komunat e Kosovës në mënyrë që të vetëdijesojnë dhe edukojnë gratë dhe partnerët e tyre mbi shëndetin e nënës dhe fëmijës.

Fëmijët po përballen me mungesën e shërbimeve sociale. Në nivel komunal, shërbimet sociale në komunitet janë kryesisht për fëmijët me aftësi të kufizuara dhe operojnë vetëm në disa komuna. Këto shërbime sociale po ofrohen nga qendrat e kujdesit ditor (të administruara nga OJQ-të), por shërbimet e tilla kanë mbetur kryesisht nën mbështetjen e agjencive dhe donatorëve të huaj, ndërkohë që mbështetja shtetërore nuk është e strukturuar, nuk është e qëndrueshme dhe në të njëjtën kohë mbetet shumë e kufizuar. Bazuar në mandatin e tyre ligjor, MPMS bashkë me komunat duhet të ofrojnë shërbime sociale të bazuara në komunitet për fëmijët me aftësi të kufizuara dhe fëmijët tjerë në nevojë duke ndikuar edhe në zhvillimin në fëmijërinë e hershme.

Zhvillimi i programeve dhe shërbimeve për fëmijëri të hershme do të ketë ndikim pozitiv në shumë fusha:

- Shërbime cilësore, efektive dhe mbështetëse për fëmijë;
- Përkujdesje më e mirë prindërore;
- Shërbime të qasshme – rritje e numrit të fëmijëve që marrin shërbime;
- Integrim më i mirë i fëmijëve të cenueshëm;
- Profesionistë dhe kujdestarë të trajnuar;
- Politika dhe programe më të mira për fëmijët në nivel nacional dhe lokal.

Rekomandime:

- Zhvillimi i programeve alternative për zhvillimin në fëmijërinë e hershme sikurse programet për mbështetjen e prindërve, qendrat në komunitet, qendrat ditore, kujdesi për fëmijët në familje, ndërhyrja në fëmijërinë e hershme, grupet e prindërve, vizitat sistematike në shtëpi, ekipet mobile për fëmijëri të hershme, platformat online për fëmijëri të hershme;
- Nxjerrja e Udhëzuesit për Regjistrimin e Qendrave Mësimore, regjistrimi i Qendrave të Mësimi Shtesë dhe subvencionimi i këtyre qendrave;
- Zgjerimi i programit Klasa për Nëna dhe Fëmijë në kuadër të QMF-ve në të gjitha komunat e Kosovës në mënyrë që të vetëdijesojnë dhe edukojnë gratë dhe partnerët e tyre mbi shëndetin e nënës dhe fëmijës.

Afati kohor: 12 muaj.

Partneriteti publiko - privat si mundësi për rritje të përfshirjes së fëmijëve në edukim parashkollor

Edukimi parashkollor në Kosovë, organizohet në institucionet parashkollore publike (çerdhet dhe kopshtet) dhe institucionet parashkollore private, kopshtet me bazë në komunitet, qendrat mësimore dhe klasat përgatitore të cilat funksionojnë në kuadër të shkollave fillore (niveli parafillor).

Sfidat me të cilat përballet edukimi parashkollor në Kosovë, përfshijnë: shpërndarjen jo adekuate të institucioneve parashkollore në vend (vetëm 23 nga 34 komuna të Kosovës kanë së paku një institucion parashkollor publik të fëmijëve deri në moshën 6 vjeçare); numri i vogël i institucioneve parashkollore publike (vetëm 42 institucione parashkollore publike në mbarë vendin); mungesa e infrastrukturës së përshtatshme për moshën e fëmijëve; mungesa e materialeve didaktike dhe materialeve shpenzuese të cilat nevojiten për organizimin e aktiviteteve të cilat mundësojnë të mësuarit përmes lojës, e të tjera.¹⁰

Bazuar nga raportet, informatat dhe diskutimet me përfaqësues të institucioneve të ndryshme të nivelit qendror dhe lokal, me palë të interesit si dhe akterë të tjerë të fushës së edukimit parashkollor mund të konkludohet se nismat private/apo me bazë në komunitet dhe partneritetet publike-private shihen si mënyra të zbatueshme për të përmirësuar pjesëmarrjen në arsimin parashkollor, veçanërisht për fëmijët e moshës 0 - 5 vjeç. Për të menaxhuar këtë nismë do të jetë thelbësore të mbështetet njësia e arsimit parashkollor në MASHT si dhe komunat për të përmirësuar qeverisjen e përgjithshme.

Arsyetimi:

Infrastruktura paraqet problemin themelor në përfshirjen e fëmijëve në edukimin parashkollor. Numri i vogël i kopshteve publike ka pamundësuar përfshirjen në masë më të madhe të fëmijëve të kësaj moshe. Përfshirja e fëmijëve në institucionet parashkollore publike është me pagesë dhe tarifa përcaktohet nga komunat përkatëse bazuar në mesataren e të ardhurave, ndërsa, fëmijët që vijnë nga grupet e marginalizuara janë të liruar nga pagesa.

Përderisa arsimiti përgatitor i ofruar në shkollat fillore është falas, shpenzimet e edukimit në institucionet parashkollore publike ndahen ndërmjet prindërve dhe komunave me tarifën mesatare mujore për një fëmijë që ndryshon nga €40 deri në €50. Gjithashtu, në mungesë të institucioneve parashkollore publike në Kosovë funksionojnë një numër i institucioneve parashkollore private, me tarifa që ndryshojnë nga €80 deri në €240. Kjo është një barrë relativisht e rëndë për familjet e Kosovës, me të ardhura mesatare mujore nga 280 deri në 360 €.

Në anën tjetër gjendja aktuale në sektorin e arsimit/edukimit privat, tregon që ka nevojë për veprime konkrete për zhvillimin dhe ngritjen e cilësisë së këtij sektori po edhe rritjen e numrit të fëmijëve të përfshirë në programe të fëmijërisë së hershme. Në bazë të hulumtimit të dokumenteve aktuale del se komunat ende nuk kanë plan veprimi se si do t'i qasen sektorit privat dhe si do ta ndihmojnë zhvillimin e këtij sektori. Duke pasur parasysh rritjen e shërbimeve të institucioneve private viteve të fundit, komunat duhet t'i qasen seriozisht partneritetit me sektorin privat që do të mundësonte rritjen e përfshirjes së fëmijëve në këtë nivel edukimi, por njëkohësisht edhe monitorimin e ofrimit të shërbimeve të tyre.

Institucionet përgjegjëse të nivelit qendror dhe lokal duhet të marrin parasysh se investimi në fëmijërinë e hershme sjell efekte të tërthorta në përmirësimin e suksesit të nxënësve në shkollimin e mëtutjeshëm dhe po ashtu në rritjen e përfshirjes së femrave në tregun e punës.

Modeli i kopshteve me bazë në komunitet ka filluar të zbatohet për herë të parë në Komunën e Prishtinës. Ky model parashihet edhe në Ligjin për Edukimin Parashkollor¹¹, sipas të cilit në rastet kur në rrethin e vendbanimit të fëmijëve nuk ka institucione parashkollore, komuniteti ka të drejtë të vetë-organizohet, për të ofruar shërbime të edukimit parashkollor.

¹⁰ KEEN, Edukimi parashkollor në Kosovë, Rrjeti i Kosovës për Arsim dhe Punësim – 2018, http://www.keen-ks.net/site/assets/files/1445/edukimi_parashkollor_ne_kosove_alb.pdf

¹¹ MASHT, Ligji nr. 02/I-52 mbi Edukimin Parashkollor, 2006, <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2401>

Të dhënat për kopshtet me bazë në komunitet në komunën e Prishtinës tregojnë rritjen e numrit të fëmijëve të përfshirë në edukimin parashkollor të të gjitha moshave. Institucionet parashkollore me bazë në komunitet paraqesin një mundësi të re për të rritur numrin e fëmijëve në edukimin parashkollor duke shmangur kufizimet buxhetore të autoriteteve qendrore dhe lokale për institucione parashkollore, pasi që kryesisht funksionojnë nga të hyrat vetanake, me mbështetje të vogël nga komuna.

Partneritetet Publiko Private aplikohen për të mundësuar ofrimin e shërbimeve publike me kosto të përballueshme ekonomike, por edhe për të zhvilluar qasje gjithëpërfshirëse të komunitetit.¹² PPP do të thotë çfarëdo formë e bashkëpunimit ndërmjet autoriteteve publike dhe sektorit privat i cili përfshinë ndarjen e rrezikut me qëllim të sigurimit të financimit, ndërtimit, riparimit, menaxhimit, operimit dhe/ose mirëmbajtjen e një infrastrukture dhe/ose sigurimin e një shërbimi. PPP-ja do t'i referohet Koncesioneve, Projekteve Greenfield, dhe/ose cilitdo kombinim nga kjo.¹³

Një partneritet publiko-privat institucional mund të themelohet nga një komunë përmes blerjes nga një ose më shumë partner privat të aksioneve të komunës në një ndërmarrje publike ekzistuese, funksioni i vetëm i së cilës është kryerja e një shërbimi publik ose ofrimi i një infrastrukture publike, me kusht që partneri privat po ashtu merr pjesë në drejtimin e ndërmarrjes publike ose merr pjesë në kryerjen e shërbimit publik ose ofrimin e infrastrukturës publike.¹⁴

Një lloj i tillë i bashkëpunimit ndërmjet sektorit publik dhe privat në zhvillim po rritet në shumë vende tjera dhe PPP po përdoren gjithnjë e më shumë si një mënyrë për të adresuar sfidat dhe boshllëqet në arsim.

Rekomandime:

- Të hartohen udhëzime administrative, rregullore dhe procedura të qarta për organizimin dhe rregullimin e sektorit publiko-privat që përcaktojnë edhe kriteret, standardet, menaxhimin, monitorimin, inspektimin, etj;
- Meqenëse Ligji për PPP aktualisht është në rishikim e sipër rekomandohet të përfshihen zyrtarë apo përfaqësues të fushës së arsimit të cilët do të mund të kontribuonin në avancimin dhe përcaktimin e fushës së arsimit për partneritet/kontraktim publiko-privat;
- Të pilotohet modeli për PPP së paku në dy komuna ku ka numër të madh të fëmijëve dhe ku paraqiten nevoja për të investuar në edukim parashkollor;
- MASHT të ofrojë asistencë teknike për komunat e zgjedhura për të zhvilluar dhe menaxhuar PPP si dhe ofruesit e arsimit parashkollor për të zhvilluar dhe zbatuar PPP.

Afati kohor: 24 muaj.

¹²D&D Business Support Center, Udhëzues për partneritet publik-privat, 2017, http://dd-bsc.com/ep_content/uploads/2018/09/UDHËZUES-PËR-PART-NERITET-PUBLIKO-PRIVAT-MAPL_2017.pdf

¹³Ligji nr. 04/I-045 për partneritet publiko privat, 2011, <https://gzk.rks.gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2784>

¹⁴Ligji nr. 04/I-045 për partneritet publiko privat, 2011, <https://gzk.rks.gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2784>

Infrastruktura dhe standardet minimale

Standardet e vetme të hartuara në zhvillimin e fëmijërisë së hershme janë standardet e përgjithshme të edukimit dhe arsimit parashkollor në Kosovë të hartuara në vitin 2006, të cilat janë vetëm për moshën 3 – 6 vjeç, duke mos përfshirë moshën 0 – 3 vjeç. Rekomandohet plotësim ndryshimi i standardeve të edukimit parashkollor për të përfshirë moshën 0 – 6 vjeç dhe për të rregulluar mangësitë e identifikuara lidhur me infrastrukturën dhe standardet minimale sikurse ato të sigurisë dhe shëndetit.

Këto standarde konsiderohen si bazë e cila parashton kërkesat dhe kriteret që duhet t'i respektojnë institucionet parashkollore. Standardet shërbejnë për të udhëhequr zhvillimin, vlerësimin dhe përmirësimin e veprimtarisë edukative të institucioneve parashkollore për fëmijët e moshës 3 - 6 vjeç. Këto standarde janë të detyrueshme për t'u zbatuar në të gjitha institucionet parashkollore publike, private, paralelet parafillore dhe qendrat me bazë në komunitet (QBK).

Poashtu rekomandohet rritja e cilësisë së inspektimit të standardeve, përmes profilizimit të inspektorëve në fushën e fëmijërisë së hershme, ngritjes së kapaciteteve dhe pajisjes me instrumentet e nevojshme për nivelin parashkollor.

Arsyetimi:

Standardet e edukimit dhe arsimit parashkollor në Kosovë janë vetëm për moshën 3 – 6 vjeç, duke mos përfshirë moshën 0 – 3 vjeç. Institucionet parashkollore kanë mungesë të standardeve të sigurisë dhe shëndetit dhe se kjo sjellë shumë vështirësi dhe sfida si tek udhëheqësit e institucioneve parashkollore po ashtu edhe tek prindërit. Përkundër që këto standarde janë hartuar në vitin 2006 shumë prej kërkesave që ofrojnë këto standarde mbeten ende të pa përfillura dhe të pazbatueshme nga ofruesit e programeve parashkollore dhe institucioneve parashkollore publike dhe private edhe pse ato licensohen mbi bazën e këtyre standardeve. Dokumenti i standardeve të përgjithshme ka nevojë që të rishikohet dhe avansohet për t'i paraprirë zhvillimeve në vend dhe për t'iu përgjigjur kërkesave që ngërthen fusha e fëmijërisë së hershme.

Infrastruktura e brendshme dhe e jashtme aktuale në nivelin parashkollor në Kosovë nuk përmbush Standardet Ndërkombëtare të Klasifikimit të Arsimit (ISCED) në fëmijëri të hershme. Hapësirat e jashtme dhe të brendshme, ndërtesat, orënditë, materialet e punës, lojërat dhe mjetet didaktike duhet të jenë të përshtatshme në përdorim për secilin fëmijë, varësisht nivelit të tyre të zhvillimit apo nevojave të veçanta duke mbështet kështu edukimin gjithëpërfshirës.

Duhet të krijohen ambiente të jashtme stimuluese për lojë dhe mësim, gjithashtu të sigurohen kënde për sjelljen e ambienteve të jashtme brenda hapësirave të klasave përgaditore, si këndet e rërës, të ujit, të bimëve, etj. Duhet të nxisim zhvillimin e hapësirave ekologjike brenda dhe jashtë objekteve të cilat do të ndikojnë në edukimin e qëndrueshëm tek fëmijët.

Mjediset brenda dhe jashtë institucioneve dhe qendrave që ofrojnë shërbime të fëmijërisë së hershme të jenë organizuara në mënyrë të tillë që ofrojnë siguri, qetësi, mirëqenie, qasje dhe ndërveprim me njerëzit dhe objektet.

Inspektimi për institucionet parashkollore realizohet nga inspektorët në kuadër të MASHT të cilët nuk janë të profilizuar dhe nuk janë të paisur me instrumentet e nevojshme për nivelin parashkollor. Si pasojë, nuk ka një inspektim cilësor në zhvillimin në fëmijërinë e hershme.

Rekomandime:

- Plotësim ndryshimi i standardeve të edukimit parashkollor për të përfshirë moshën 0 – 6 vjeç dhe për të rregulluar mangësitë e identifikuara lidhur me infrastrukturën dhe standardet minimale;
- Rritja e cilësisë së inspektimit të standardeve, përmes profilizimit të inspektorëve në fushën e fëmijërisë së hershme, ngritjes së kapaciteteve dhe pajisjes me instrumentet e nevojshme për nivelin parashkollor.

Afati kohor: 24 muaj.

Koalicioni i OJQ-ve për Mbrojtjen e Fëmijëve në Kosovë – KOMF, është një koalicion i përbërë nga 29 organizata jo qeveritare vendore dhe ndërkombëtare të cilat punojnë në fushën e mbrojtjes së fëmijëve, me mision të përbashkët avokimin për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve në Kosovë.

Organizatat anëtare të KOMF janë:

Asociacioni për Trajnime Sociale, Hulumtime dhe Avokim – ASTRA, Aksioni për Nëna dhe Fëmijë, Balkan Sunflowers Kosova, Childproof/CIPOF, Education Comes First – ECF, Iniciativa 6, Organizata Rinore Akti – Ora, Organizata për Fëmijët pa Kujdes Prindëror – OFAP, OPFAKKOS, Programi për të Drejtat Civile – CRP/K, PL4Y International, Qendra për Arsim e Kosovës – KEC, Qendra e Kujdesit Ditor PEMA, Qendra për Mbrojtjen e Viktimave dhe Parandalimin e Trafikimit të qenieve njerëzore – MVPT, Qendra për Studime të Avancuara – FIT, Qendra Kosovare për Rehabilitimin e të Mbijetuarve të Torturës – QKRMT, Save the Children, SOS Fshatrat e Fëmijëve Kosovë, Shpresa dhe Shtëpi për Fëmijët Kosovë – SDSF, Shoqata e të Drejtave të Pacientëve në Kosovë – PRAK Kosova, Shoqata e Paraplegjikëve dhe e Paralizës së Fëmijëve të Kosovës – HANDIKOS, Terre des hommes, The Ideas Partnership, VoRAE, World Vision, Public Organization for Local Initiatives and Supports – POLIS, Network of Peace Movement – NOPM, Qendra Sociale – Edukative SOS Kopshti dhe Nevo Koncepti.



Koalicioni i OJQ-ve për Mbrojtjen e Fëmijëve
Zenel Salihu, OB.1 HY.1 K.3 No.16, 10000
Prishtinë, Kosovë
Tel: +383 (0) 38 220 287
www.komfkosova.org